



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:045102
Datë: 03.10.2024
Numri i dokumentit: 06245842

Kom.Dh.Shk.II.nr.1257/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “Kosova Asphalt” SH.P.K., me NUI:811052646, me seli në fshatin Gaçkë, Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arlinda Haziri avokate në Prishtinë Rr.”Luan Haradinaj K1, nr.11-1, kundër debitorit “Toifor” Sh.P.K., me NUI:810484890, me seli në Prishtinë Rr.”Lidhja e Prizrenit”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1676/22, të datës 23.04.2024, me datë **02.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e kreditorit “Kosova Asphalt” SH.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1676/22, të datës 23.04.2024, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1676/22, të datës 23.04.2024, në dispozitiv të aktvendimit ka aprovuar prapësimin e debitoit “Toifor” Sh.P.K., me NUI:810484890, ashtu që është anuluar Urdhri Përmbartimor P.nr.10/22 i datës 18.01.2022 i Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shumolli dhe është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1676/22, të datës 23.04.2024, apo ndryshohet apo lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë duke theksuar se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i ligjshëm dhe nuk përmban asnjërin nga shkeljet e dispozitave të LPP-së andaj ka kërkuar nga Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë –Departamenti për Çështje Ekonomike të refuzoj në tërësi të pabazuar ankesën e kreditorit ndërsa të vertetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1676/22, të datës 23.04.2024.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.10/22 të datës 18.01.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – fatura me numër 73 e datës 23.08.2018; fatura me numër 151 e datës 10.12.2018; fatura me numër 57 e datës 06.08.2019; fatura me numër 142 e datës 05.02.2019; fatura me numër 143 e datës 05.02.2019; fatura me numër 160 e datës 19.12.2019; fatura me numër 161 e datës 19.12.2019; fatura me numër 189 e datës 30.12.2019; fatura me numër 13 e datës 08.05.2020; fatura me numër 47 e datës 10.07.2020; fatura me numër 75 e datës 24.09.2020; fatura me numër 76 e datës 24.09.2020; fatura me numër 112 e datës 06.11.2020; fatura me numër 139 e datës 07.12.2020; fatura me numër 144 e datës 10.12.2020; fatura me numër 170 e datës 26.12.2020; fatura me numër 109 e datës 09.11.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj borxhin e mbetur nga faturat e lartcekura në shumë prej 256,452.92 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga rënia në vonesë e deri në ditën e pagesës definitive.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se fatura me numër 151 e datës 10.12.2018 dhe fatura me numër 73 e datës 23.08.2018, nuk i plotësojnë kushtet për përmbartim ngase janë të parashkruara, po ashtu fatura me numër 189 e datës 30.12.2019 dhe fatura me numër 170 e datës 26.12.2020, nuk përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbartimit për shkak se të njëjtat nuk janë të pranuar dhe të nënshkruara nga debitori. Tutje ka theksuar se të gjitha faturat tjera të bashkangjitura në propozim janë kopje dhe nuk janë të vërtetuara te noteri. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovoj si të bazuar prapësimin dhe të anulohet urdhri për përmbartim dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndër të tjerash ka theksuar se shkeljet e pretenduara në prapësim nuk ekzistojnë. Ka shtuar se kreditori me propozim ka bashkangjitur faturat origjinal të cilat edhe gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk qëndron pretendimi që fatura me numër 151 e datës 10.12.2018 dhe fatura me numër 73 e datës 23.08.2018, janë parashkruar ngase për të njëjtat fatura debitori ka ndërprerë parashkrimin duke kryer pagesa të

pjesshme. Tutje ka theksuar se janë përmbushë të gjitha kushtet ligjore për inicimin e procedurës përmbartimore dhe se debitori pretendimet në prapësim nuk i ka mbështetur në asnjë provë. I ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pa themeltë, të mbetet në fuqi Urdhri për Përmbartim P.nr.10/22 të datës 18.01.2022, si dhe të detyrohet debitori t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1676/22, të datës 23.04.2024, ku në dispozitiv të aktvendimit ka aprovuar prapësimin e debitorit "Toifor" Sh.P.K., me NUI:810484890, ashtu që është anuluar Urdhri Përmbartimor P.nr.10/22 i datës 18.01.2022 i Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shumolli dhe është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se duke u bazuar në shkresat e lëndës, faturat në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme.

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata Komerciale - Dhoma e shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.10/22 të datës 18.01.2022, në lidhje me faturën me numër 189 e datës 30.12.2019 dhe faturën me numër 170 e datës 26.12.2020, pasi që në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit, ndërsa fatura me numër 109 e datës 09.11.2021, fatura me numër 75 e datës 24.09.2020, fatura me numër 112 e datës 06.11.2020, fatura me numër 139 e datës 07.12.2020, fatura me numër 144 e datës 10.12.2020, fatura me numër 143 e datës 05.12.2019 dhe fatura me numër 142 e datës 05.12.2019, janë dorëzuar në kopje të pa vërtetuara.

Me të drejtë po ashtu është vlerësuar se fatura me numër 151 të datës 10.12.2018 dhe fatura me numër 73 të datës 23.08.2018 në shumën prej 133,936.77 €, janë parashkruar sipas nenit 355 të LMD, pasi që propozimi i kreditorit për përmbartim është paraqitur me datë 18.01.2022, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit / arritjes për pagesë.

Mirëpo, Gjykata e Shkallës së dytë nuk mund të përkrah si të qëndrueshëm përfundimin e shkallës së Parë në lidhje me faturat me numër 57 e datës 06.08.2019; fatura me numër 160 e datës 19.12.2019; fatura me numër 161 e datës 19.12.2019; fatura me numër 13 e datës 08.05.2020; fatura me numër 47 e datës 10.07.2020, të cilat plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform dispozitave ligjore të LPP-së, mirëpo kreditori nuk ka precizuar vlerën e përgjithshme të borxhit. Gjykata e Shkallës së Parë nëse ka pasur dilema në lidhje me lartësinë e borxhit për faturat e lartcekura të cilat i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm meqë të njëjtat janë të nënshkruara dhe vulosura, është dashur ta ftoj kreditorin në seancë të bëjë precizimin e lartësisë së borxhit, apo ta lë në fuqi Urdhrin Përmbartimor për faturat e lartcekura. Andaj, me qëllim të harmonizimit të shkresave në lëndë, gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësojë nëse faturat i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm

konform dispozitave ligjore të LPP-së, ashtu qe me qellim te konstatimit real te detyrimeve te debitorit marrë për bazë edhe pretendimet e palëve ne procedure, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë duhet ta këtë parasysh nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili thotë, se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përgjithësisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga gjykata, arsye këto nga te cilat rezulton se aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.*

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se në këtë rast nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të aprovuar prapësimin e debitorit prandaj, ankesën e kreditorit e pranoi si të themeltë dhe çështjen vendosi t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike të vlerësojë dokumentin përmbarimor, se a i plotëson kushtet nga neni 29 par.3 të LPP-së, e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1257/24 me datën 02.10.2024

Gj y q t a r i,
Faton Bajrami